



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për parandalimin e torturës,
trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201801996/2

Tiranë ___/___/2019

Lënda : *Rekomandime për inspektimin e kryer në Drejtorinë Vendore të Policisë, Tiranë.*

Drejtuar : **Drejtues i Parë Kastriot SKËNDERAJ**
Drejtor i Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë

TIRANË

Për dijëni: **Drejtues Madhor Ardi VELIU**
Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit

TIRANË

I nderuar z. Skënderaj,

Avokati i Popullit, në rolin e Mekanizmit Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues, në vijim Mekanizmi Kombëtar,¹ bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, kreu një inspektim në ambientin e shoqërimit dhe të sigurisë në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë. Inspektimi i krye në datën 20.09.2018, sipas Planit të Inspektimit të miratuar nga Avokati i Popullit.

Në përbërje të grupit inspektues mori pjesë znj. Ermonela Xhafa, Komisionere e Mekanizmit Kombëtar, z. Sotiraq Nushi, me detyrë Nd/Komisionerë pranë Seksionit të Veçantë dhe z. Besnik Deda me detyrë Nd/Komisionerë pranë Mekanizmit Kombëtar.

Inspektimi kishte si qëllim verifikimin e respektimit të standardeve të përcaktuara në ligjin nr. 108/2014, "Për Policinë e Shtetit", Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 1102, datë 07.11.2017, për miratimin e procedurës standarde "Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre", Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 306, datë 31.03.2016, për miratimin e procedurës standarde "Rregullat teknike

¹ Neni 74/1 i ligjit nr. 8328, datë 16.04.1998, "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", i ndryshuar.

të shoqërimit në polici”, si dhe zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit të bëra gjatë inspektimeve të mëparshme.

Institucioni i Avokati i Popullit, pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues ka detyrimin kushtetues dhe ligjor t’ju parashtrijë konkluzionet përfundimtare, duke ju referuar si më poshtë vijon:

Shënime paraprake

Në përputhje me metodologjinë e zhvillimit të inspektimit në institucionet ku mbahen e trajtohen shtetas të privuar nga liria, grupi i inspektimit u takua me z.Kastriot Skënderaj, Drejtor i Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë, si dhe me z.Dhimitraq Ziu Zv/Drejtor për Sigurinë Publike pranë kësaj drejtorie, të cilët u vunë në dijeni lidhur me qëllimin e inspektimit.

Zv/Drejtori për Sigurinë Publike në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë, informoi gjithashtu dhe mbi masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit nga inspektimi i mëparshëm, lidhur me përmirësimin e kushteve dhe standardeve në ambientet e shoqërimit dhe ato të sigurisë, për respektimin dhe garantimin e të drejtave kushtetuese dhe ligjore të personave të privuar nga liria.

Grupi i inspektimit, pasi mori informacionin e nevojshëm mbi masat e marra për mbajtjen, trajtimin dhe sigurimin e personave që qëndrojnë në mjediset e drejtorisë të policisë, vijoi takimin me shefin e dhomave të sigurisë dhe punonjësit e policisë të zyrës së informacionit dhe të shërbimit në dhomat e sigurisë.

Grupi monitorues inspektoi në vend ambientet e shoqërimit dhe ato të sigurisë, disa nga zyrat e punonjësve të policisë të kësaj drejtorie, si dhe u njoh me të gjithë dokumentacionin përkatës ku pasqyroheshin veprimet e kryera me personat e shoqëruar dhe të arrestuar/ndaluar.

Nga informacioni i grumbulluar gjatë kryerjes së inspektimit, rezultoi se ambientet e shoqërimit dhe të sigurisë në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë, në tërësinë e tyre ishin të ndërtuara sipas procedurave standarde të parashikuara në aktet normative dhe dokumentat ndërkombëtare.

Nga verifikimi i rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit nga inspektimi mëparshëm, grupi i inspektimit konstatoi se, nuk ishin zbatuar rekomandimet që lidhen me:

- krijimin e dhomës (zyrës) më vete në ambientin e shoqërimit, për marrjen në pyetje të personave të shoqëruar, të arrestuar/ndaluar nga oficerët e policisë gjyqësore para se të dërgohen në ambientet e sigurisë dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera;
- shtimin në organikë të një mjeku me kohë të plotë në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë, pasi prezenca e një mjeku për drejtorinë dhe komisariatet e policisë në varësin e saj është e pamjaftueshme. Konkretisht, nga inspektimi në Komisaratin e Policisë Kavajë konstatoam se, me urdhër nr.1102 datë 07.11.2017 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë të Shtetit, detyra e mjekut ishte deleguar mjekut të përgjithshëm të Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë. Kjo e bënte të pamundur ushtrimin efektiv të detyrës të mjekut, njëkohësisht në të gjitha komisariatet në varësi të kësaj drejtorie për shkak të distancës relativisht të madhe mes tyre, por dhe dinamikës të lartë të arrestimeve/ndalimeve në këto komisarate.

- në dhomat e sigurisë nuk ishte riparuar dhe vënë në punë sistemi i ngrohjes dhe dushi me ujë të ngrohtë për larjen e trupit të personave që qëndrojnë në këto ambiente; si dhe,
- nuk funksiononte telefoni fiks që ndodhej në koridorin e dhomave të sigurisë dhe shërbente për komunikimin e punonjësve të shërbimit me zyrën e informacionit në rast nevojë dhe butoni me zile/sinjali të montuar në muret e brendshme të dhomave për kontaktin e të arrestuarve/ndaluarve me punonjësin e policisë.

Theksojmë se, gjatë kryerjes të inspektimit në ambientet e shoqërimit dhe dhomat e sigurisë të kësaj drejtorie, punonjësit e policisë në të gjitha nivelet, u treguan bashkëpunues dhe transparentë me grupin e inspektimit.

Në përfundim të inspektimit grupi monitorues konstatoi se, në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë, vazhdojnë të jenë të pranishme disa problematika dhe konkretisht:

Ambientet e shoqërimit dhe kushtet e tyre

Në Drejtorinë Vendore të Policisë, Tiranë, ambienti shoqërimi ishte i ndërtuar sipas kërkesave të parashikuara në ligjin nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit” dhe procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.306, datë 31.03.2016.

Ambienti i shoqërimit kishte 3 (tre) dhoma dhe ishte i ndarë më vete për shoqërimin e personave të rritur, femra dhe të mitur sikurse parashikohet në aktet e ligjore dhe nënligjore.

Grupi i inspektimit, konstatoi se, dhomat e shoqërimit ishin me sipërfaqe dhe hapësira të bollshme, të pajisura me orënditë e nevojshme tavolinë dhe karrige të fiksuara në dysheme, për qëndrimin ulur të shtetasve të shoqëruar. Dhomat ishin të pajisura me dritare me përmasa që krijojnë mundësinë e ajrimit dhe ndriçim të plotë natyral. Po ashtu, dhomat ishin të pajisura me ndriçim artificial nga rrjeti elektrik. Në këtë ambient, kishte tualete të cila ishin ngjitur me dhomat e shoqërimit dhe i ndarë më vete për femra dhe meshkuj. Ato ishin të lyera dhe të pastëra nga ana higjiene-sanitare.

Nga inspektimi në ambientin e shoqërimit u konstatua se, mungonte dhoma (zyra) më vete për marrjen në pyetje të personave të shoqëruar. Marrja në pyetje/intervistimi i këtyre personave kryhej në zyrat e punës të punonjësve të policisë deri në përfundim të verifikimit të problemit apo kryerjes së veprimeve procedurale, për të cilin këta persona ishin shoqëruar në organin e policisë.

Gjithashtu, në ambientin e shoqërimit mungonte sistemi i monitorimit me kamera për mbajtjen në vëzhgim të korridorit dhe dhomës së shoqërimit.

Mungesa e këtyre elementëve, mund të përbëjë shkak për përdorimin e mjeteve dhe metodave jo të përshtatshme për shoqërimin, mbajtjen dhe trajtimin e personave në mjediset e policisë, si dhe për respektimin dhe garantimin e të drejtave që ju njeh ligji këtyre personave.

Ambientet e sigurisë dhe kushtet e tyre

Në Drejtorinë Vendore të Policisë, Tiranë ambienti i sigurisë ishte ndërtuar sipas normave, kushteve dhe standardeve për mbajtjen, trajtimin dhe sigurimin e personave të arrestuar/ndaluar, që përcaktohen në procedurën standarde “Trajtimi dhe sigurimi i

personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.1102, datë 07.11. 2017.

Grupi i inspektimit konstatoi se, gjendja e dhomave në ambientin e sigurisë, në lidhje me përmirësimin e disa kushteve fizike për trajtimin dinjitoz të personave të arrestuar/ndaluar që qëndrojnë në këtë ambient, nuk kishte ndryshuar nga inspektimi i mëparshëm.

Në ambientin e sigurisë kishte 8 (tetë) dhoma sigurie, me destinacion 6 (gjashtë) për meshkuj madhorë, 1 (një) për femra dhe 1 (një) për të mitur. Dhomat e sigurisë janë të ndara dhe mundësojnë akomodimin e 10 (dhjetë) personave të arrestuar/ndaluar, sipas kapacitetit të tyre.

Sipërfaqet dhe hapsirat në dhomat e sigurisë ishin të bollshme për qëndrimin dhe akomodimin e 10 personave të arrestuar/ndaluar. Dhomat e sigurisë ishin të kompletuara me orënditë e nevojshme si krevat, dyshekë, jastëk dhe batanije.

Brenda ambientit të dhomave të sigurisë ndodhej dhoma për mjekun e pajisur me orënditë e nevojshme, si shtrat, tavolinë, karrige, rafte dhe pajisje për ngrohje.

Gjithashtu, në ambientin e sigurisë kishte dhomë më vete për intervistimi/marrjen në pyetje dhe takim me avokatin e të ndaluarve/arrestuarve, të pajisur me tavolinë dhe karrige të fiksuara në dysheme në mënyrë të palëvizshme.

Në ambientet e jashtme, në korridorin e dhomave të sigurisë dhe dhomën e intervistimit/marrjes në pyetje ishte instaluar sistem monitorimi audio-vizive i cili ruhej për një afat një mujor.

Në koridorin e dhomave të sigurisë kishte të instaluar telefon fiks për komunikimin e punonjësve të shërbimit me zyrën e informacionit në rast nevoje, si dhe buton zileje/sinjali të montuar në muret e dhomave për kontaktin e të arrestuarve/ndaluarve me punonjës të policisë, por të dyja këto paisje nuk funksiononin.

Sistemi i ngrohjes në dhomat e sigurisë ishte jashtë funksionit, duke mos ju garantuar shërbimin këtyre personave në periudhën e dimrit. Ngrohja sigurohej me pajisje elektrike të siguruara nga vetë personat që qëndronin në këto ambiente, brenda kushteve të sigurisë dhe rregullave të miratuara për dhomat e sigurisë.

Grupi inspektues konstatoi se, në tualetet e dhomave të sigurisë kishte furnizim normal me ujë të rrjedhshëm për mbajtjen e pastërtisë të ambientit dhe higjienës vetjake, por mungonte dushi me ujë të ngrohtë për larjen e trupit. Dhomat e sigurisë kishin gjenerator si burim rezervë të energjisë në rast ndërprerje të energjisë elektrike.

Në tërësinë e tij ambienti i sigurisë nuk plotësonte disa nga kushtet dhe kriteret e parashikuara në procedurat standarde, për trajtimin dinjitoz të shtetasve të arrestuar/ndaluar dhe kryerjen e detyrës nga punonjësit e policisë që kryejnë shërbim në këto ambiente.

Regjistri i personave të shoqëruar, ndaluar/arrestuar dhe evidentimi i tyre

Të dhënat për personat e shoqëruar në Drejtorinë Vendore të Policisë, Tiranë, regjistroheshin në “Regjistrin e evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar”, i cili ishte hapur sipas procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”. Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se ishte i sekretuar dhe rubrikat e tij ishin plotësuar. Koha

e qëndrimit të shtetasve në gjendje shoqërimi ishte e ndryshme nga 1 deri në 10 orë në raste të veçanta.

Ndërsa të ndaluarit/arrestuarit nga punonjësit e policisë të këtij komisariati evidentoheshin në regjistrin e personave të ndaluar/arrestuar, i cili ishte po ashtu i sekretuar.

Institucioni i Avokatit të Popullit, nga verifikimi i rregjistrave ku evidentohen të dhënat për personat shoqëruar dhe të arrestuar/ndaluar në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë, për rastin e ndalimeve nga banorët e Bashkisë Kukës, për tubimin e datë 31.03.2018 për anulimin e taksës së “Rrugës së Kombit”, ka konstatuar shkelje në lidhje me dokumentimin e orës, kur këta persona kanë hyrë në mjediset e policisë Tiranë.

Konkretisht, në këta regjistra rezultonte se personat kanë hyrë në mjediset e policisë Tiranë midis orës 08:00 të mëngjesit dhe 09:30 të datës 1.4.2018, çka do të thotë se këtyre personave duke qenë se janë banorë të Kukësit dhe ishin ndaluar në Kukës iu ishte privuar liria minimalisht 2 orë më parë, nëse do të marrim kohën që duhet për të përshkuar rrugën nga qendra e qytetit të Kukësit e deri në Tiranë. Madje, grupi i inspektimit të Institucionit të Avokatit të Popullit, konstatoi se në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë deri në orën 17.45, të datës 01.04.2018, të ndaluarve nuk iu ishte dhënë asnjë dokument për veprimet e kryera nga Policia.

Kjo praktikë, bie ndesh me rekomandimin e Avokatit të Popullit, si për rastet e ankesave të trajtuara ashtu edhe nga inspektimet e bëra në organet e Policisë së Shtetit duke kërkuar që, në rastet kur për personat e shoqëruar në organet e policisë vendoset arrestimi apo ndalimi, në procesverbalin e arrestimit në flagrancë ose të ndalimit duhet vihet ora e shoqërimit të tyre dhe jo ora kur përpilohet procesverbali i arrestimit/ndalimit.

Rekomandimet e Avokatit të Popullit janë bazuar jo vetëm në parimet universale të së drejtës dhe në parimet e përgjithshme të së drejtës tonë penale, por edhe në dispozitat konkrete të Kodit të Procedurës Penale respektivisht nenet 144, 250 dhe 259 të tij.

Trajtimi i të ndaluarve/arrestuarve dhe i të shoqëruarve në ambientet e policisë.

Në kohën e inspektimit në ambientet e shoqërimit në Drejtorinë Vendore të Policisë, Tiranë, nuk kishte asnjë person të shoqëruar. Ndërsa në ambientin e sigurisë ndodheshin 7 persona nga të cilët 3 të arrestuar/të ndaluar në moshë madhore, 3 femra dhe 1 minoren. Pavarësisht situatës në kohën e inspektimit, Institucioni i Avokatit të Popullit në rastin e shoqërimit dhe ndalimit të personave nga banorët e Bashkisë Kukës menjëherë pas tubimit të datës 31.03.2018, ka konstatuar mbi popullim në dhomat ku janë mbajtur dhe trajtuar personat e arrestuar/ndaluar në këto ambiente. Kjo praktikë përbën shkelje të të drejtave të personave të arrestuar/ndaluar, të garantuara me aktet ligjore dhe nënligjore, si dhe me dokumentet ndërkombëtare.

Grupi i monitorimit intervistoi të gjithë personat e ndaluar/arrestuar, të cilët konfirmuan se ishin trajtuar në mënyrë korrekte gjatë kohës së marrjes në pyetje nga oficerët e policisë gjyqësore dhe qëndrimit në ambientin e sigurisë. Nga të intervistuarit nuk pati pretendime për trajtim denigrues, jo human apo për ushtrim dhune fizike e psikologjike. Gjendja psikologjike e të intervistuarve ishte e qetë dhe nuk dëshmonte për pasoja të shaktuara nga keqtrajtimi. Të intervistuarit nuk dëshmuuan frikë apo druajtje për të raportuar keqtrajtimin e tyre.

Shtetasit e intervistuar kishin dijeni për identitetin e punonjësit të policisë me të cilin kishin marrë kontakt dhe kishin kryer veprimet procedurale. Ata shpjeguan se, gjatë ndalimit/arrestimit punonjësit e policisë ishin identifikuar përpara tyre duke u prezantuar me gjeneralitetet dhe detyrën që kryenin.

Koha e qëndrimit të arrestuarve në ambientin e sigurisë ishte brenda afatit ligjor, ndërsa për personat e ndaluar me vendim gjykatë, për shkak të ekzekutimit të vendimeve të dënimit të tyre penal bëhej menjëherë shkresa Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve për transferimin në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale.

Nga informacioni i dhënë nga punonjësit e policisë që shërbenin në dhomat e sigurisë dhe pyetja e personave të ndaluar/arrestuar rezultoi se të ndaluarit/arrestuarit trajtoheshin me ushqim tre herë në ditë sipas normave për trajtimin me ushqim të përcaktuar në urdhrin e përbashkët nr. 432, datë 10.03.2008 të Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Shëndetësisë. Ushqimi përgatitej dhe sillej nga një subjekt privat me të cilin ishte lidhur kontratë.

Ndonëse në ambientet e sigurisë nuk kishte ambiente kulti, të ndaluarve/arrestuarve që dëshironin u lejohej ushtrimi i riteve fetare brënda dhomave të sigurisë.

Të ndaluarve/arrestuarve iu jepeshin produkte për ruajtjen e higjienës vetjake dhe të ambientit, si sapun, detergjente, letra higjienike dhe letra për fshirjen e duarve dhe të fytyrës.

Ambientet e intervistimit

Në dhomat e shoqërimit të Drejtorisë Vendore të Policisë, Tiranë, nuk kishte dhomë më vete të monitoruar me kamera për intervistimi/marrjen në pyetje të shtetasve të shoqëruar. Ndërsa në dhomat e sigurisë kishte dhomë më vete, për marrjen në pyetje të ndaluar/arrestuarve nga prokurori dhe avokati tij privat.

Shtetasit e ndaluar/arrestuar, para se të ndaloheshin apo arrestoheshin dhe të futeshin në ambientet e sigurisë, intervistoheshin nga oficerët e policisë gjyqësore në zyrat e punës së këtyre të fundit. Avokati i Popullit e konsideron procesin e monitorimit filmik² një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve e arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së shtetit ndaj tyre.

Nga monitorimi që u bë në disa prej zyrave të punonjësve të policisë që u ndodhën në këtë komisariat nuk u gjetën sende, prania e të cilave të ekspozonte dhunë ndaj personave me të cilët ata kryenin veprime procedurale.

Ndihma juridike, psikologjike dhe kujdesi mjekësor

² “Një sistem i monitorimit të vazhdueshëm i standardeve dhe procedurave të intervistave të policisë duhet vënë në zbatim, po ashtu; kjo kërkon një regjistrim të saktë të intervistave të personave në ambientet e policisë, të cilat, nëse është e mundur duhet të zhvillohen me pajisje regjistruese elektronike (audio dhe/video). Duhet të kërkohet që të regjistrohet në mënyrë sistematike koha kur ka filluar dhe mbaruar intervista, ndonjë kërkësë të bërë nga i ndaluar gjatë intervistës, si dhe të personave të pranishëm gjatë çdo interviste.” CPT’ reports; Armenia: Visit 2010[par.18]

Gjatë inspektimit u konstatua se në korridoret, në ambientin e shoqërimit dhe të sigurisë të Drejtorisë Vendore të Policisë, Tiranë, ishin të afishuara posterat me të drejtat e personave të ndaluar/arrestuar, si dhe atyre të shoqëruar, të cilat ishte e nevojshme të rifreskoheshin me të reja.

Sipas punonjësve të policisë, të ndaluarit/arrestuarit dhe të shoqëruarit njiheshin me të drejtën për të pasur një avokat mbrojtës gjatë marrjes në pyetje, dhe ata që e kishin kërkuar iu ishte krijuar mundësia për të kontaktuar me të. Nga pyetja e punonjësve të policisë rezultoi se në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit madhorë të cilët nuk kishin mundësi financiare për të pasur avokat privat dhe kërkonin ndihmë juridike, atyre avokati ju sigurohej nga prokurori, sipas dispozitave të K.Pr.Penale.

Informacioni i dhënë nga punonjësit e policisë u konfirmua edhe nga pyetja e të arrestuarve/ndaluarve, të cilët deklaruan se ishin njohur me të drejtat ligjore nga punonjësit e policisë kur ishin marrë në pyetje dhe ishin takuar me avokatët e tyre.

Personave të ndaluar/arrestuarve iu ishin dhënë nga oficerët e policisë gjyqësore kopje të procesverbalit të ndalimit/arrestimit, të kontrollit personal dhe të letrës me të drejtat e tyre.

Për shtetasit e huaj të arrestuar/ndaluar komunikimi me punonjësit e policisë dhe prokurorin bëhej në gjuhën amtare apo në një nga gjuhët që ata kuptojnë nëpërmjet avokatit apo një përkthyesi. Po ashtu, për këta persona kishte letra, në 10 nga gjuhët e huaja më kryesore, me të drejtat e tyre.

Të arrestuarve/ndaluarve u ishte bërë vizita mjekësore brënda afatit 12 orë nga mjeku i Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë,³ i cili ishte i punësuar me kohë të plotë. Vizitat mjekësore, rekomandimet dhe mjekimet regjistroheshin në regjistrin e vizitave mjekësore që mbahej nga përgjegjësi i ambientit të sigurisë të këtij komisariati. Mjeku mbulonte ndërkohë dhe vizitat mjekësore në dhomat e sigurisë në disa prej komisariatet e policisë të Tiranës. Për shkak të ngarkesës, del e nevojshme shtimi në organik dhe me një mjek të përgjithshëm për mbulimin në kohë të vizitave mjekësore në ambientet e sigurisë të organeve të policisë në varësinë tuaj.

Gjithashtu në dhomat e sigurisë ishte vendosur edhe regjistri i kërkesë/ankesave të personave të arrestuar/ndaluar, por nuk ishte evidentuar asnjë kërkesë apo ankesë.

Në këtë komisarikat zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 109/5 dhe 122/5 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 të procedurave standarde për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë, që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimit të çështjes përkatëse.

Për sa më sipër, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku parashikohet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike” dhe në bazë të nenit 21/b të ligjit nr. 8454 dt.04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”, me qëllim zgjidhjen e problemeve të konstatuara gjatë këtij inspektimi,

³ *Kreu II, pika 7/b e procedurave standarde: “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”.*

REKOMANDOJMË :

1. Marrjen e masave të nevojshme për krijimin në ambientin e shoqërimit të dhomës (zyrës) për marrjen në pyetje të personave të ndaluar/arrestuar nga oficerët e policisë gjyqësore para se të dërgohen në ambientet e sigurisë dhe instalimin brenda saj të sistemit të monitorimit me kamera.
2. Marrjen e masave të menjëhershme për instruktimin e punonjësve të policisë për plotësimin me përgjegjësi dhe saktësi të rubrikave në “Regjistrin e evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar dhe të arrestuar/ndaluar”, kryesisht për dokumentimin e saktë të orës, pra kur shtetasit shoqërohen për në komisariatit e policisë, koha kur ju privohet liria dhe jo kur hyjnë në mjediset e policisë.
3. Marrjen e masave të nevojshme për shtimin në organikë të një mjeku të përgjithshëm me kohë të plotë në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë, me qëllim parandalimin e situatave të padëshiruara, pasi prezenca e një mjeku për drejtorinë dhe të gjitha komisariatet në varësin e saj është e pamjaftueshme.
4. Marrjen e masave të nevojshme për vënien në punë të sistemit të ngrohjes në dhomat e sigurisë, sipas kriterëve të parashikuara në procedurën standarde.
5. Marrjen e masave të menjëhershme për riparimin e dushit me ujë të ngrohtë për larjen e trupit të personave të arrestuar/ndaluar, kur ndodhen në ambientin e sigurisë.
6. Marrjen e masave për vënien në funksionim të plotë të telefonit fiks që ndodhet në koridorin e dhomave të sigurisë për komunikimin e punonjësve të shërbimit me zyrën e informacionit në rast nevojë, si dhe të butonit me zile/sinjali të montuar në murin brenda dhomave të sigurisë për kontaktin e të arrestuarve/ndaluarve me punonjësin e policisë.
7. Nxjerrjen e përgjegjësive dhe marrjen e masave ndaj personave përgjegjës në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë, për mos zbatimin e rekomandimeve të bëra nga Institucioni i Avokatit të Popullit në inspektimin e mëparshëm.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brënda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.

KOMISIONER

Ermonela XHAFJA